


RAPORT TEKNIK

OBJEKTI: **HARTIM PROJEKTI
MBROJTJE DHE SISTEMIM ME PRITA MALORE I PËRROIT TË GOMSIQES**

ADRESA: **PËRROI I GOMSIQES, PUKE**

KERKUESI: **KESH SHA**



PËRGATITUR NGA:



BOE: "NET GROUP" SHPK & "ARABEL STUDIO" SHPK

2023

Përmbajtja

1	HYRJE.....	3
1.1	OBJEKTII I REALIZIMIT TË PROJEKT ZBATIMIT.....	3
1.2	PERSHKRIM I PERGJITHSHEM I ZONES SE PROJEKTIT DHE STATUSIT AKTUAL....	4
1.3	VLERESIMI I PRURJEVE TE NGURTA QE TRANSPORTON LUMI I GOMSIQES.....	12
1.4	PASOJAT NGA VAZHDIMI I GRUMBULLIMIT TE PRURJEVE TE NGURTA NE DELTEN E GOMSIQES DHE LIQENIN E VAUT TE DEJES.....	14
1.5	NDERHYRJET INXHINERIKE TE MEPARSHME NE SISTEMIMIN E PERROIT TE GOMSIQES OSE PROJEKTET E HARTUARA PER KETE QELLIM	16
1.6	ZGJIDHJET INXHINERIKE TE PROPOZUARA PER SISTEMIMIN E LUMIT TË GOMSIQES	16
1.7	TIPET, NUMRI DHE LARTESIA E PRITAVE TE PROJEKTUARA PER SISTEMIMIN E LUMIT TE GOMSIQES.....	23
1.7.1	Numri dhe lartesia e pritave te propozuara dhe projektuar.....	23
1.7.2	Tipi pritave te propozuara dhe projektuar.....	26
2	STUDIMET NDIHMESE PER HARTIMIN E PROJEKT- ZBATIMIT TE STRUKTURAVE PER SISTEMIMIN E LUMIT TE GOMSIQES.....	30
2.1	STUDIMI HIDROLOGJIK.....	30
2.2	STUDIM MBI KUSHTET GJEOLGJIKE TE PELLGUT DHE PERROIT TE GOMSIQES	41
2.2.1	Hyrje.....	41
2.2.2	KARAKTERISTIKAT GJEOMORFOLOGJIKE TE PELLGUT UJEMBLEDHES TE GOMSIQES.....	43
2.2.3	TE DHENA MBI NDERTIMIN GJEOLGJIK TE PELLGUT TE GOMSIQES	44
2.2.3.1	Formacioni mbulesor.....	44
2.2.3.2	Formacioni rrenjesor.....	45
2.2.4	KUSHTET GJEOLGJO-INXHINERIKE TE ZONES SE STRUKTURAVE TE MBROJTJES NGA PRURJET E NGURTA.....	46
2.2.5	KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME.....	48
2.2.6	ÇËSHTJE ME RËNDËSI SPECIFIKE NDAJ PROJEKTIMIT TE STRUKTURAVE MBROJTESE NGA PRURJET E NGURTA.....	49
2.3	RILEVIMI TOPOGRAFIK I ZONES SE SISTEMIMIT TE LUMIT TE GOMSIQES	49
3	PROJEKTIMI PRITAVE ME GABIONE NE RRJEDHJEN E POSHTME TE LUMIT TE GOMSIQES.....	52
3.1	KRITERET E ZGJEDHJES SE PRITAVE ME GABIONE.....	52
3.2	PROJEKTIMI I PRITAVE ME GABIONE.....	53
3.2.1	Permasimi i pritave me gabione.....	53
3.2.2	Llogaritjet statike te trupit te pritave me gabione.....	53
3.2.3	Llogaritjet hidraulike te prites dhe pusit te shuarjes se energjise.....	84
3.3	GRAFIKU I PUNIMEVE.....	96
3.4	VOLUMET PER REALIZIMIN E PUNIMEVE	96
3.5	NDARJA E PUNIMEVE NE DY LOTE.....	97
3.6	PLANI I ORGANIZIMIT TË PUNIMEVE.....	99

1. HYRJE

1.1 OBJEKTI I REALIZIMIT TË PROJEKT ZBATIMIT


Kompania "NET GROUP" shpk & "ARABEL STUDIO" shpk e kontraktuar nga KESH sh.a. me Kontrate Nr.2241.5 date 25.05.2023 ka marre persiper realizimin e projekteve te zbatimit te objekteve "**Hartim projekti mbrojtje dhe sistemim me prita malore i perroit te Gomsiqes**" ne perputhje te plote me kerkesat e Termave te References, detyrën e projektimit dhe kontratn e konsulencës..

KESH sh.a. në përputhje me programin ekonomik 2023, do të realizojë projektin e zbatimit (studim, projektim) me objekt: "**Hartim projekti mbrojtje dhe sistemim me prita malore i perroit te Gomsiqes**"

Projekti për mbrojtjen dhe sistemimi e përroit të Gomsiqes eshte i lidhur me zvogelimin e efekteve te grumbullimit te aluvioneve dhe mbetjeve te ngurta ne liqenin e Vaut te Dejes, kryesisht ne rrjedhen e poshtme te tij deri ne shkarkimin në liqenin e Vaut të Dejës, si dhe përmirësimin e pritave ekzistuese të cilat e kanë kryer rolin dhe qëllimin e realizimit të tyre nga tejmbushja me prurjet e ngurat të sjellë nga lumi i Gomsiqes. Gjatë hartimit të këtij projekti do të merret në studim edhe një degë përroi që shkarkon prurjet ujore dhe të ngurta në këtë lum, e cila ka sjellë prurje të ngurta në mënyrë të pavullnetshme dhe të padisiplinuara kryesisht gjatë dy viteve të fundit 2022-2023 dhe ka krijuar depozitime shumë të mëdha të prurjeve të ngurta.

Sipas termave të referencës: duhet të eliminohen fenomenet negative si dhe të reduktohet erozioni i madh që paraqesin zonat e rrjedhës së sipërme dhe të mesme të lumit te Gomsiqes dhe përrenjve sipër tij, bllokimin e hyrjes në liqen të këtij materiali, si dhe pengimin e mëtejshëm të depozitimeve në deltën e këtij lumi, duke siguruar nje projekt zbatimi që do të japë një zgjidhje të përshtatshme të mbrojtjes së zonës nga rrjedha e sipërme e tyre deri në grykëderdhjen në liqenin e Vaut të Dejes si dhe zvogelimit në të ardhmen të prurjeve të ngurta në liqen.

Zona për të cilën do të hartohet projekti ndodhet në liqenin e H/C Vaut te Dejës. Ne anën e djathtë të tij (në drejtim të rrjedhjes), ndodhet Lumi i Gomsiqes dhe në anën e majtë të lumit të Gomsiqes ndodhet përroi i Dushit. Të dy këto trupa rrjedhjesh ujore malore kanë respektivisht edhe pellgjet ujëmbledhëse të tyre.



Fotot 1 Harta topografike e derdhjes së lumit Gomsiqe në liqenin e Vaut të Dejes

1.2 PERSHKRIM I PERGJITHSHEM I ZONES SE PROJEKTIT DHE STATUSIT AKTUAL I TIJ

Vend - ndodhja e projektit

Lumi i Gomsiqes ndodhen në anën e djathtë të liqenit të Vaut të Dejes. Ky perrua derdhet ne liqenin e HEC-it te Vaut te Dejes ne nje kuote rreth 76-77 mmnd. Në vëndmatjen hidrometrike të lumit të Gomsiqes në kuotën +100 mmnd, ky lume ka një sipërfaqe të pellgut ujëmbledhës prej afro 136 km² dhe mbledh ujrat e reshjve të cilat kanë një vlerë deri ne 2000 mm. Ky Lumë ka një pjerrësi të madhe dhe një pellg ujëmbledhës me prurje të mëdha në kohë mjaft të shkurtër. Këto prurje janë të shoqëruara edhe me transportin e sedimenteve të shumta të cilat prej vitesh kanë mbushur në mënyre të ndjeshme liqenin e HEC Vau i Dejes. Zona e basenit ujëmbledhës të lumit të Gomsiqes bën pjesë në krahinën malore qëndrore të rrethit të Pukës.

Pellgu i Gomsiqes ka nje shtrirje gjatesore qe fillon me majat e Sekes se Prenkallit (1298 m) dhe maja e Kumbullise (1460 m) ne lindje, me majen e Rrases se Qerreti ne veri, majat e Gjutes dhe Mrozit ne Jug deri ne shkarkim ne liqenin e Vaut te Dejes rreth 3.5 km nga diga e Qyrsaqit. Gjatesia e lumit te Gomsiqes nga fillimet e tij deri ne derdhje eshte rreth 34 km.

Pellgu ka nje siperfaqe te pergjithshme prej rreth 139 km² dhe ka nje dege kryesore, ate te perroit te Dushit ne veri te tij me pellg ujembledhes rreth 30 km² dhe gjatesi te vijes se rrjedhjes rreth 11.5 km.

Pershkrimi i situates aktuale ne zonen e projektit.

Zona e projektit eshte investiguar qe nga derdhja ne liqenin e Vaut te Dejes deri ne fshatin Gomsiqe (Ura e Gomsiqes) qe perben rreth 60% te siperfaqes se rrjedhjes se poshtme te pellgut te Gomsiqes duke perfshire pellgun e Dushes dhe qe ne opinionin paraprak formohet pjesa me e madhe e prurjeve te ngurta qe transportohen nga rrjedha e ujit per ne liqenin e Vaut te Dejes.

Pershkrimi i situates ekzistuese ne kete metodologji do te perqendrohet ne kuptimin me te mire te fenomeneve qe kane ndodhur dhe vazhdojne te ndodhin ne zonen e projektit si dhe ne aspektet qe ndikojne ne zgjedhjet e duhura per tipin e strukturave te projektit si dhe elementet qe do te perdoren per hartimin e projektit te zbatimit per mbrojtjen dhe sistemimin e lumit te Gomsiqes.

Perpara ndertimit te HEC te Vaut te Dejes dhe mbushjes se liqenit te tij lumi i Gomsiqes derdhej normalisht ne lumin Drin se bashku me prurjet e ngurta qe transportoheshin prej tij. Nga koha kur liqeni i Vaut te Dejes eshte krijuar morfologjia e zones se derdhjes se lumit ne liqen ka ndryshuar ne menyre te konsiderueshme. Meqenese liqeni i Vaut te Dejes ka lekundje te vogla te niveleve te ujit ne derdhje te lumit te Gomsiqes eshte krijuar nje delte shume e gjere duke ndryshuar relievin e zones sic shihet ne fotot 3.1 me poshte.



Fotot 2 Delta e shkarkimit te lumit ne liqenin e Vaut te Dejes.

Sipas termave të referencës, kjo e investiguar edhe në terren: Në pjesën e mesme të rrjedhës së këtij lumi në kuotën rreth 150 mmnd, bëhet bashkimi i ujrave me perroin e Dushit duke rritur ndjeshëm sasinë e prurjeve dhe fuqinë gërryese në këtë zonë si dhe sasinë e prurjeve të ngurta që derdhën në liqenin e Vaut të Dejës.

Zona mbi hyrjen e këtyre përrenjve në grykën karbonatike, përfaqëson një zonë të paqëndrueshme nga pikëpamja gjeologjike, me formacione lehtësisht të errodeshëm, me shpate me pjerrësi të madhe. Kjo ka bërë të mundur që aftësia gërryese e këtij lumi dhe disa degëve të tij në këte zonë, të sjellë materiale të ngurta në sasi të mëdha në zonën e kanionit karbonatik, duke e depozituar në grykëderdhjen e tij, në liqenin e Vaut të Dejës. Për pasojë, këto depozitime janë bërë shqetësuse për lëvizjen normale të ujit në këtë zonë të liqenit të Vaut të Dejës. Prej vitesh, sasia e materialeve inerte të sjella nga ky lum ka sjellë një situatë problematike për nivelin e dobishëm të ujit në liqenin e Vaut të Dejës si dhe mbushjes së tij me sedimente dhe prurje të ngurta duke bërë të domosdoshme ngritjen prej më se 5 m të nivelit të Urës së ndërtuar në këtë zonë.

Nje tregues i ketij fenomeni eshte mbulimi pothuaj i plote i ures mbi lumin Gomsiqe sic tregohet ne Fotot 3.2 me poshte. Mbushja e shtratit te lumit arriti deri tek ura duke e nxjerre jashte perdorimit ate plotesisht si rezultat u projektua dhe ndertua nje ure e re sic tregohet ne foton 3.3. Por procesi i mbushje vazhdon dhe ne perspektive edhe ura e re do te humbase hapesirat e drites duke eliminuar funksionin e saj. Nje fakt per nje pohim te tille eshte hapesira ne veri te ures e cila ka kuote me te ulet foto 3.4 dhe mbushjet e lumit do te devijonte rrjedhjet ne kete hapesire ku nuk ka ure duke ndryshura rrjedhjen dhe nxjerre jashte funksionit vete uren e re te ndertuar.



Fotot 3 Ura auto e vjetër e bllokuar dhe e mbuluar nga prurjet e ngurta



Fotot 4 Prita ekzistuese me gabiona, në afërsi të deltës së lumit ku bashkohet me liqenin.

Duke u ngjitur me lart shtratit te lumit te Gomsiqes veme re qe jane ndermarre disa nderhyrje mbrojtese por keto pervecse jo korrekte nga pikepamja inxhinierike jane ndertur me funksion mbrojtjen e tokave dhe shtepive ne te djathte te rrejdhes dhe jo per te penguar prurjet e ngurta nga lumi



Fotot 5 Murë guri në të thatë për mbrojtjen e banesave dhe të tokave.



Fotot 6 Pritë ekzistuese Nr.2 (Pusi i shuarjes)



Fotot 7 Pritë ekzistuese Nr.2

Kjo pritë e ka humbur funksionin e parandalimit të prurjeve të ngurta nga tejmbushja e saj. Topografia e relievit të brigjeve në funksion me rrugën auto, tokat dhe banesat e fshatit Dush, e lejon mbilartësimin e sajë me prita të reja.



Fotot 8 Pritë ekzistuese Nr.3 (e shkatërruar nga mbulimi me prurje të ngurta)

Nga tejmbushja me prurje të ngurta dhe vërshimi i prurjeve të mëdha gjatë periudhave me reshje, siç shihet edhe nga fotoja 8 pusi i shuarjes së kësaj prite është shkatërruar duke e humbur plotësisht funksionin e saj.



Fotot 9 Pritë ekzistuese, djathtas Nr.5

Shtrati i lumit në afërsi të deltës me liqenin e vaut të Dejës, murë ekzistues në të djathtë sipas drejtimit gjatësor të lumit për mbrojtjen e tokave dhe të shtëpive.



Fotot 10 Pritë ekzistuese Nr.3

Kjo pritë ekzistuese ka dalë jashtë funksionit për shkak të shkatërrimit të saj, nga vërshimi i prurjev ujore dhe të ngurta, kjo për shkak të tejmbushjes së saj me prurje të ngurta dhe gërryerja e themelit në anën e jashtme të pragut kapërderdhës.



Fotot 11 Pritë ekzistuese Nr.2, që kufizohet më rrugën

Shpatulla e kapërderdhësit siç shihet edhe në foton 11 është në kuotën e rrugës auto në të majtë të saj (sipas drejtimit të kundërt të rrjedhës së lumi), kjo nuk lejon mbilartësim të të kapërderdhësit

Detyra Kryesore që Duhet të Zgjidhë Projekti

Nëpërmjet projektit: "**Hartim projekti mbrojtje dhe sistemim me prita malore i perroit te Gomsiqes**" duhet të evitohet/minimizohet grumbullimi i prurjeve të ngurta dhe efekti negativ i tyre në liqenin e Vaut te Dejes nga lumi i Gomsiqes dhe përrrenjtë e mësipërm. Në realizim të detyrës së mësipërme projekti duhet të studjojë:

- Fenomenin e ardhjes së prurjeve te ngurta intensive nga lumi i Gomsiqes dhe përrrenjtë e tij, origjina e tyre, masat e mëparshme të marra që nga ndërtimi i HEC të Vaut të Dejes, efektiviteti i këtyre masave, gjëndja e tyre sot dhe arsyet e dëmtimit / mosefektivitetit të tyre.
- Te analizojë ndërhyrjet inxhinierike të zbatuara në vite për kete qëllim dhe efektivitetin e tyre. Në këtë kuadër, projektuesi duhet te analizoje dhe të marrë në konsideratë cdo projekt të mëparshëm të hartuar dhe / ose zbatuar për këtë qëllim dhe ta integrojë dhe konsiderojë atë si pjesë e zgjidhjes së përgjithshme të këtij fenomeni duke përfshirë edhe përmirësime të tij / tyre nëse gjykohet e nevojshme. Projekti i ri të ofrojë plotësime të masave të parashikuara në projektet e mëparshme duke filluar mbi zonën e pritave malore të parashikuara mbi kuotën 77.0 m.
- Mbi bazën e studimeve të mësipërme të jepen zgjidhjet inxhinierike efikase (në të paktën dy opsione) në plotësim të detyrës kryesore të projektimit nëpërmjet:
 - Nje studimi të detajuar hidrologjik të pellgjeve ujëmbledhës duke u përqëndruar në prurjet maksimale të tyre.
 - Rilevimit topografik të zonës ku do të planifikohen pritat malore në shkallë 1:500 me kuota absolute. Në zonën ku do të vendosen akset e pritave, relievi të jete më i detajuar.
 - Studimit gjeologjik ku të përfshihet harta gjeologjike e zones dhe profilet gjeologjike sipas akseve të pritave të projektuara.
 - Projektimit të strukturave të pritave malore për të siguruar qëndrueshmërinë e tyre në kushtet e prurjeve maksimale si dhe sigurimin e shuarjes së energjisë të prurjeve në anën e poshtme për të shmangur shkatërrimin dhe rritjen e jetëgjatësisë së tyre.
 - Të bëhet studimi i zonës së deltës në grykëderdhjet e lumit te Gomsiqes dhe perroit të Dushit,
 - Te behet analiza tekniko ekonomike e zgjidhjeve inxhinierike te propozuara
Për të realizuar këtë projekt të kryhen:
 - Rilevimi topografik i zonës në shkallën që do të gjykohet nga projektuesi.
 - Rilevimi batimetrik i zonës nënujore në pjesën e shkarkimit të ujrave të lumit dhe përrrenjëve përkatës
 - Vlerësimi i volumeve të materialit të grumbulluar në delta dhe shtrirja e tyre në zonën respektive të liqenit.
 - Studimi gjeologo – Inxhinierik dhe Gjeoteknik i zonës ku do të ndërtohen pritat malore si dhe i zonës së pellgut ujëmbledhës të lumit të Gomsiqes
 - Studimi hidrologjik i basenit ujëmbledhës
Studimi i vlerësimit të ndikimit në mjedis

1.3 VLERESIMI I PRURJEVE TE NGURTA QE TRANSPORTON LUMI I GOMSIQES

Lumi i Gomsiqes disponon nje stacion hidrometrik rreth kuotes 100 mmnd i cili ka funksionuar per nje kohe te gjate. Te dhenat e matjeve ne kete stacion ne drejtim te prurjeve te ngurta te tij jane te pakta, te c'rregullta ne kohe dhe nuk mund te sherbejne per vleresimin e sakte te tyre. Ne kemi perdorur metoda alternative per vleresimin ketyre prurjeve qe megjithese te peraferta na japin nje ide te qarte per volumin e tyre dhe tendecen e grumbullimit te tyre ne kupen e liqenit te Vaut te Dejes. Vlersimi yne eshte mbeshtetur ne matjet e batimetrise se liqenit ne zonen e deltes se krijuar ne derdhje te lumit te Vaut te Dejes. Nga ana tjeter jane shfrytezuat hartat e vjetra topografike te zones perpara krijimit te liqenit te Vaut te Dejes. Nga diferencat e sipërfaqeve te prerjeve terthore karakteristike jane percaktuar volumet e mbushjeve si rezultat i prurjeve te ngurta te transportuara nga lumi i Gomsiqes.

Ne figuren 12 me poshte jepet gjendja e zones se shkarkimit te perroit te Gomsiqes ne lumin Drin perpara krijimit te liqenit te Vaut te Dejes ne te cilen jane ndertuar seksionet terthore ne zonta karakteristike te saj




Fig. 12 Zona e shkarkimit te lumit te Gomsiqes perpara krijimit te liqenit

Ndersa ne fig.13 jepet topografia e fundit e liqenit te Vaut te Dejes te matur gjate muajit Korrik 2023. Mbi bazen e matjeve te batimetrise eshte ndertuar topografia si dhe prerjet terthore te deltes se krijuar ne shkarkimin e lumit te Gomsiqes ne liqenin e Komanit ne te njejtat pozicione me ato te hartes se meparshme.

Mbi bazen e differences se seksioneve terthore jane percaktuar volumet e mbushjeve ose prurjet e ngurta te trasnportuara nga lumi i Gomsiqes.

Llogaritjet jane permbledhur ne tabelen 1.




Fig.13 Zona e shkarkimit te lumit te Gomsiqes ne gjendjen aktuale te tij

PIKETA	SIPERFAQJA	SIP. MESATARE	DISTANCA	VOLUMI PJESOR (m3)	VOLUMI PROGRESIVE (m3)
C1	0				
C2	1,531	765	200	153,093	153,093
C3	835	1,183	200	236,591	389,684
C4	782	809	200	161,725	551,408
C5	486	634	200	126,832	678,240
C6	383	435	200	86,927	765,168
C7	583	483	200	96,611	861,779
C8	750	666	200	133,246	995,024
C9	981	866	200	173,107	1,168,131
C10	5,281	3,131	200	626,215	1,794,346
C11	6,186	5,733	200	1,146,633	2,940,980
C12	4,641	5,413	200	1,082,618	4,023,598
C13	4,273	4,457	200	891,395	4,914,992
C14	4,900	4,587	200	917,393	5,832,386
C15	5,747	5,324	200	1,064,784	6,897,169
C16	5,330	5,539	200	1,107,756	8,004,925
C17	4,344	4,837	200	967,466	8,972,391
C18	5,127	4,736	200	947,119	9,919,509
C19	4,317	4,722	200	944,422	10,863,931
C20	4,073	4,195	200	839,023	11,702,953

C21	1,501	2,787	200	557,420	12,260,374
C22	610	1,056	200	211,134	12,471,507
C23	507	558	200	111,690	12,583,197
					12,583,197

Tab.1 Tabele permbledhese e llogaritjeve te volumeve te grumbulluara ne delten e Gomsiqes

Sic rezulton nga llogaritjet e mesiperme volumi i vleresuar eshte rreth 12.6 milion m³. Ne vleresimin e mesiperme duhet te kemi parasysh qe matjet e batimetrisse te realizuar kane nje saktesi te mjaftueshme per nje llogaritje te sakte te prurjeve te ngurta ndersa rezervat qendrojne tek topografia e gjendjes perpara mbushjes se liqenit te cilat per shkak te shkalles dhe saktetise se saj priten devijime nga gjendja reale qe ndikon ne saktesine e llogaritjeve te sakta. Per te marre parasysh nje shkalle gabimi rreth 10% mund te vleresojme qe volumi i mbushjeve vleresohet te jete rreth 15-16 milion m³.

Liqeni i Vaut te Dejes eshte mbushur ne vitin 1971, kohe ne te cilen edhe prurjet e ngurta nga lumi i Gomsiqes kane filluar te grumbullohen ne zones se shkarkimit te tij ne liqen. Pra ne 52 vite te ekzistences se liqenit prurjet e ngurta te lumit te Gomsiqes duke perjashjashtuar ato pezull jane grumbulluar ne kete delte duke sjelle si pasoje gjendjen e sotme. Rrjedhimisht prurjet mesatare vjetore te grumbulluara ne delten e Gomsiqes jane rreth 350 000 m³ ne vit.

Volumi i grumbullimit vjetor nga lumi i Gomsiqes eshte i konsiderueshem dhe nese nuk merren masa qe eshte objekt i ketij projekti do te kishte pasoja jo vetem ne zonen e deltes por edhe ne liqenin e Vaut te Dejes.

1.4 PASOJAT NGA VAZHDIMI I GRUMBULLIMIT TE PRURJEVE TE NGURTA NE DELTEN E GOMSIQES DHE LIQENIN E VAUT TE DEJES

Grupi i projektimit studjoi zonen e deltes se Gomsiqes ne pjesen e zbuluar te saj (mbi kuoten e liqenit te Vaut te Dejes) dhe ate nen-ujore bazuar ne matjet batimetrike te gjithë zones se deltes dhe liqenit perreth kesaj kesaj zone. Qellimi i ketij studimi ishte te:

- Te percaktonte progressin e mbushjeve te ngurta ne trungun kryesor te liqenit te Vaut te Dejes
- Te percaktonte kurben e avancimit te mbushjeve ne drejtim te liqenit
- Shtrirjen e mbushjeve ne zonen mbi kuoten e liqenit dhe tendencen e mbushjeve

Nga studimi i problemeve te mesiperme u arrit ne konkluzionet e meposhtme:

1. Prurjet e ngurta do te vazhdojne te mbushin delten e Gomsiqes me tendence mbushjen e seksionit te liqenit nepermjet gjirit te Gomsiqes qe ndodhet rreth 1.5 km nga digat respektive te Qyrsaqit dhe Zadejes sic shihet ne fig.3 ne vazhdim.

Kjo per faktin qe eshte rritur pjerresia e mbushjeve ne delte dhe tenton te rreshqase ne drejtim te ngushtices me drejtim

2. Zona mbi nivelin e liqenit te Vaut te Dejes vazhdon te mbushet por tashme ritmi i mbushjes do te rritet. Kjo do te beje qe jo vetem rrezikon mbushjen e seksionit te liqenit si me siper por nxjerrjen jashte funksionit te ures se re te ndertuar. Nje mbushje e metejshme ne kete zone do te kerkonte zevendesimin me nje ure me gjatesi dyfishin me ekzistuesen. Por qe do luante funksionin e nje dige qe ne vazhdim do mbushej perseri.

Projekti i zbatimit per sistemimin e perroit te Gomsiqes do te krijoje kushte per stabilizimin e regjimit te prurjeve te ngurta ne rrjedhjen e poshtme te tij duke krijuar nje hapësire depozituese te lire por edhe ne zvogelimin e konsiderueshem te pjerresise se shtratit ne kete zone qe do te kete efekte stabilizimi kundrejt erozionit si rezultat te zvogelimit te shpejtesive te rrjedhjeve. Sidoqofte projekti nuk mund te eliminoje kalimin e materialit te imet te prurjeve te ngurta por nje material i tille pervec sasive shume te reduktuara qe do te mund te kalojne nuk do te sjell asnje efekt negativ ne regjimin e liqenit te Vaut te Dejes.

Projekti aktual nuk zgjidh perfundimisht problemin e prurjeve te ngurta te lumit te Gomsiqes pasi nje problem i tille do te kerkonte nje sistemim te plote te tij gjate gjithë gjatesise se rrjedhjes se tij perfshire deget por do te zhvendoste ne rrjedhjen e sipërme problemin e depozitimeve, do te zgjaste jetegjatesine e kapacitetit mbajtes te liqenit nga mbushjet e ngurta ne delten e Gomsiqes si dhe do te stabilizonte rrjedhjen e lumit te Gomsiqes ne anen e poshtme te tij duke shmangur edhe rrezikun e permbytjeve ne zonen e banuar afer tij




Fig.14 Delta e shkarkimit te lumit te Gomsiqes ne liqenin e Vaut te Dejes

1.5 NDERHYRJET INXHINERIKE TE MEPARSHME NE SISTEMIMIN E PERROIT TE LERINIT OSE PROJEKTET E HARTUARA PER KETE QELLIM

Nga investigimet ne zone rezulton te kete struktura te ndertuara nje strukture mbrojtjeje nga permytjet per te mbrojtur rrugen e fshatit dhe tokat e tij ne kete zone. Kjo strukture e perbere prej muri gabion rezulton e demtuar dhe e shkaterruar ne nje fron te saj nga prurjet e lumit. Kjo duket te kete ndodhur per shkak te cilesise dhe jashte standarteve teknike gjate ndertimit te saj. Kjo duhet rehabilituar ne projektin aktual pasi ndertimi i pritave mbrojtese ne kete projekt do ta perkeqesonte rrezikun e permytjeve ne kete zone. Krahas kësaj strukture rezulton që gjatë viteve 2015 – 2016 të jenë ndërtuar struktura pritëse klasike me gabiona në 4 pozicione të ndryshme në afërsi të deltës së lumit. Të cilat janë përshkruar më sipër si dhe të ilustruara edhe me fotot përkatëse, por krahas këtyre pritave ka lindur nevoja që të realizohet përmirësimi i tyre me mbilartësime shtesë si dhe ndërtimi i pritave të reja në përroin që bashkohet me këtë lum.

1.6 ZGJIDHJET INXHINIERIKE TE PROPOZUARA PER SISTEMIMIN E LUMIT TE GOMSIQES

Termet e References percaktojnë studimin e lumit te Gomsiqes mbi kuoten 76-77 m.m.n.d per t'u sistemuar me prita malore dhe ne varesi te fondeve ne dispozicion do te percaktohej kufiri i siperme i nderhyrjeve ne rrjedhjen e siperme te tij.

Eshte ndermarre nje analize komplekse per percaktimin e mases se erozionit ne pellgun e Gomsiqesme qellim per te percaktuar burimin e prurjeve te ngurta te transportuara nga perroi. Ne studimin hidrologjik eshte bere nje vleresim i mases se prurjeve te ngurta vjetore si dhe burimet e tyre. Nje sistemim i plote I lumit te Gomsiqes dhe degeve te tij, sic eshte theksuar me siper, ne funksion te eliminimit te plote te rrjedhjeve te ngurta do te ishte i kushtueshem dhe qe nuk justifikohet per qellimet e ketij projekti. Nga ana tjetere per te arritur nje evitim te plote te prurjeve te ngurta duhet te eliminohet burimi i tyre qe eshte erozioni jo vetem ne perrenj por edhe ne siperfaqen e pellgut. Rrjedhimisht nuk mund te justifikohet nderhyrjet inxhinierike ne shkalle te gjere ne pellgun ujembledhes si ne perrenjte kryesore ashtu edhe ne deget e tij.



Fig.15 Zona e propozuar qe do te sistemohet me prita malore ne perroin Gomsiqe

Sistemimi i lumit te Gomsiqes duhet te filloje nga shtesa dhe mbilartesimi i pritave ekzistuese, referuar topografise per mbilartesimet dhe do te shtrihet per ne rrjedhjen e poshtme bazuar ne mundesite financiare.

Do të rivlerësohen pritrat ekzistuesë për ndërhyrje të reja duke i mbilartësuar ato, ose sipas topografisë dhe në funksion të relieve duke ndërtuar të reja.

Përroi ne ndërprerje me këtë lum do të studiohet për të parandaluar prurjet e ngurta, duke e vlerësuar atë me mbrojtje lumore, me gabiona.

Per perroin e Gomsiqes pas rikunicionit te bere dhe nje analize te detajuar mbi gjendjen e pritave ekzistuese, prurjet ujore dhe te ngurta, erozionit te shkaktuar per shkak te pjerresise se shtratit te perroit, etj., si dhe pjerresise se aksit te shtratit me prita lumore te pambuluara, u konkludua per masat inxhinierike qe duhet te merren:




Fig.16 Plan Vendosja e pritave te propozuara sipas rrjetit kordinativ KRRGJSH




Fig.17 Pamje e aksit te lumit, per shtesen e propozuar ne afersi te prites ekzistuese Nr.1

Shtesa e kesaj prite do te kete pozicionimin ne terren sipas kordinatave:

Prita Nr. 1 (shtesa e re)

Orientimi	Sistemi kordinativ: Albanian 1986 / Gaus Kruger Zone 4				Sistemi kordinativ: KRGJSH			
	1	2	3	4	1	2	3	4
X	4652615.2357	4652677.7570	4652684.0878	4652621.5665	474074.2613	474136.7826	474143.1134	474080.5921
Y	4393563.8896	4393596.4677	4393584.3182	4393551.7400	4653901.3003	4653933.8784	4653921.7289	4653889.1508




Fig.18 Planimetria e shteses se propozuar ne priten Nr.1



Fig.19 Pamje e aksit te lumit, per priten e propozuar Nr.7

Kjo prite do te kete pozicionimin ne terren sipas kordinatave:

Prita e Re Nr. 7								
Orientimi	Piketa				Sistemi kordinativ: KRGJSH			
	1	2	3	4	1	2	3	4
X	4652724.0805	4652731.4172	4652801.0035	4652773.7375	474183.1061	474190.4428	474260.0291	474232.7631
Y	4393599.5321	4393631.6311	4393523.0990	4393522.0838	4653936.9428	4653969.0418	4653860.5097	4653859.4946




Fig.20 Planimetria e prites se propozuar me gabiona Nr.7.



Fig.21 Pamje e aksit te lumit, per riparimin dhe mbilartesimin e propozuar ne priten ekzistuese Nr.3.

Shtesa e kesaj prite do te kete pozicionimin ne terren sipas kordinatave

Riparim i Prites Ekzistuese Nr. 3

Orientimi	Piketa				Sistemi kordinativ: KRGJSH			
	1	2	3	4	1	2	3	4
X	4653466.2867	4653477.3382	4653455.0896	4653443.9664	474925.2788	474936.3566	474914.1022	474903.0151
Y	4393309.2520	4393281.3621	4393272.5126	4393300.3574	4653646.6493	4653618.7709	4653609.9074	4653637.7824




Fig.22 Planimetria e mbilartesimit ne priten ekzistuese Nr.3.




Fig.23 Pamje e aksit te lumit, per aksin e propozuar te prites Nr.8

Kjo prite do te kete pozicionimin ne terren sipas kordinatave

Prita e Re Nr. 8

Orientimi	Piketa				Sistemi kordinativ: KRGJSH			
	1	2	3	4	1	2	3	4
X	4653636.5053	4653675.1559	4653710.9732	4653655.4758	475095.5309	475134.1815	475169.9988	475114.5014
Y	4392776.8905	4392852.6046	4392856.7625	4392748.1004	4653114.3012	4653190.0153	4653194.1732	4653085.5111




Fig.24 Planimetria e prites se propozuar me gabiona Nr.8.



Fig.25 Pamje e aksit te lumit, per aksin e propozuar te prites Nr.8

Kjo prite do te kete pozicionimin ne terren sipas kordinatave

Prita e Re Nr. 9								
Orientimi	Piketa				Sistemi kordinativ: KRGJSH			
	1	2	3	4	1	2	3	4
X	4653601.7265	4653575.3838	4653623.9718	4653620.9905	475060.7521	475034.4094	475082.9974	475080.0161
Y	4393720.2063	4393734.3647	4393755.5275	4393728.6246	4654057.6170	4654071.7754	4654092.9382	4654066.0354




Fig.26 Planimetria e prites se propozuar me gabiona Nr.9.

1.7 TIPET, NUMRI DHE LARTESIA E PRITAVE TE PROJEKTUARA PER SISTEMIMIN E LUMIT TE GOMSIQES

1.7.1 Numri dhe lartesia e pritave te propozuara dhe projektuara

Per percaktimin e numrit dhe lartesis se pritaveqe do te projektohen per tu ndertuar per sistemimin e perroit te Gomsiqes jemi bazuar ne:

- Pjerrresine e shtratit te perroit ne zonen e caktuar per sistemim
- Pjerrresine e pranuar qe duhet te kete shtratit perroit ne anen e sipërme te pritave pas mbushjeve me aluvione
- Kapacitetin grumbullues te depozitimeve pas ndertimit te pritave
- Kufizimin ne lartesi te pritave per reduktimin e energjive te medha per te zvogeluar strukturat shuarse te energjise

Bazuar ne kriteret e mesiperme jane propozuar dhe projektuar 5 prita mbrojtese me dimensionet dhe parametrat e meposhtem:

Prita Nr.1 (Shtesa)




Fig.27 Prerja terthore e shteses me gabiona ne priten Nr.1

- Kuota e shtratit ne askin e prites 81.25 m.m.n.d
- Lartesia e prites mbi shtratit e perroit 6 m,
- Kapaciteti i vleresuar i depozitimeve ne anen e sipërme 13,129 m³
- Pjerrresia e pritshme e shtratit ne anen e sipërme pas mbushjes 1.2%

Prita Nr.7




Fig.28 Prerja terthore e prites se re me gabiona Nr.7

- Kuota e shtratit ne askin e prites 84.36 m.m.n.d
- Lartesia e prites mbi shtratit e perroit 3.64 m,
- Kapacitetii vleresuar i depozitimeve ne anen e sipërme 19,672 m³
- Pjerresia e pritshme e shtratit ne anen e sipërme pas mbushjes 1.2%

Prita Nr.3 (Riparim dhe Mbilartesim)




Fig.29 Prerja terthore e riparimit te prites ekzistuese me gabiona Nr.3

Ky seksion i prites ekzistuese me gjatesi rreth 24m eshte shkaterruar nga vershimi i perroit te Gonsiqes.




Fig.30 Mbilartësim i pritës ekzistuese me gabiona Nr.3

Prita Nr.3 do të mbilartësohet nga gjendja ekzistuese e saje (pasi të rindërtohet segmenti i shkatërruar) me 1m lartësi, sipas figures se mesiperme.

- Kuota e shtratit në askin e pritës 94.62 m.m.n.d
- Lartësia e pritës mbi shtratin e perroit 3.38 m,
- Kapaciteti vlerësuar i depozitimeve në anën e sipërme 16,947 m³
- Pjerresia e pritshme e shtratit në anën e sipërme pas mbushjes 1.12%

Prita Nr.8




Fig.31 Prerje tërthore e pritës me gabiona të propozuar Nr.8

- Kuota e shtratit në askin e pritës 100.20 m.m.n.d
- Lartësia e pritës mbi shtratin e perroit 2.80 m,
- Kapaciteti vlerësuar i depozitimeve në anën e sipërme 12.420 m³
- Pjerresia e pritshme e shtratit në anën e sipërme pas mbushjes 1.06%

Prita no.9




Fig.32 Prerje terthore e prites me gabiona te propozuar Nr.9

- Kuota e shtratit ne askin e prites 124.76 m.m.n.d
- Lartesia e prites mbi shtratit e perroit 4.74m,
- Kapacitetii vleresuar i depozitimeve ne anen e siperme 3500 m3
- Pjerresia e pritshme e shtratit ne anen e siperme pas mbushjes 11.5 %

Kjo prite nuk ka siperfaqe te madhe depozitimi per materialet e ngurta per shkak te pjerresise shume te madhe te shtratit te perroit (dege e perroit Gomsiqe), rendesia e ndertimit te saj qendron ne uljen e energjise se prurjeve te perroit. Kjo dege e perroit ne te ardhmen duhet te jete objekt studimi per shtimin e numrit te pritave.

1.7.2 Tipi pritave te propozuara dhe projektuar

Per percaktimin e tipit te pritave te propozuara dhe projektuar per t'u ndertuar per sistemimin e perroit te Gomsiqes jemi bazuar ne:

- Pjerresine e shtratit te perroit ne zonen e caktuar per sistemim;
- Gjeresine e seksionit te shtratit ne aksin e caktuar per ndertimin e prites;
- Natyren dhe madhesine e materialit te ngurte te transportuar nga prurjet e perroit;
- Mundesine fraksionimit te materialit te ngurte deri ne shkarkim ne liqenin e Vaut te Dejes;
- Pamundesine e mbeshtetjes ne bazamente shkembore te nje pjese te pritave shtratit e lumit per shkak te trashesive te medha te depozitimeve ne shtratit e tij;

Bazuar ne kriteret e mesiperme si dhe konkluzionet e arritura nga demtimi dhe shkaterrimii pritave te meparshme te ndertuara apo struktura te ngjajshme ne perrenj analoge eshte propozuar dhe projektuar nje tip i pritave mbrojtese. Tipi klasik i pritave me gabione me rrjete teli te zinguar.

Pritat me gabione

Pritat me gabione janë me klasiket për sistemet e përrënjve të përdorura me efektivitet për një kohë të gjatë dhe që vazhdojnë të përdoren me sukses edhe në ditët tona. Në luminë e Gomsiqës janë propozuar mbilartësi i pritave ekzistuese dhe ndërtim i pritave të reja. Pavarësisht masave mbrojtëse kundër faktorëve të mesipër mundësia e prishjes së tyre është e madhe.

Megjithatë pritrat e propozuara dhe projektuar me gabione janë siguruar nga të gjitha veprimet e prishme të rrymave të plotes për të evituar çdo rrezik potencial të dëmtimit të tyre gjatë shfrytëzimit.




Fig.33 Tipe muresh prej gabioni




Fig.34 Dimensionimi i rrjetave

Gabioni kuti është një strukturë e realizuar me rrjete metalike me përdredhje të dyfishtë me kemishe gjashtekëndeshe.(Fig.33-34). Teli i përdorur për prodhimin e gabioneve është me çelik të butë. Kombinimet standarte të thurjes së telit janë paraqitur në Fig.33.

Në përfundim për të forcuar strukturën, të gjitha anet janë forcuar me një tel me diametër më të madh (Fig.26), krahasuar me telin e përdorur për rrjeten. Karakteristikat e telave të paraqitura i referohen telit përpara prodhimit të rrjetës metalike. Teli i përdorur për prodhimin e gabioneve dhe për telin lidhës, duhet të ketë një rezistencë në tërheqje prej 350-500N/mm², në përputhje me UNI-EN 10223-3 për telin prej çeliku të butë. Tolerancat në tel që janë paraqitur gjejnë mbështetje dhe në UNI-EN 10218(T1). Zgjatjet:

Zgjatja duhet të jetë më e vogël se 10% në përputhje me UNI-EN 10223-3.

Galvanizimi duhet të jetë i tipit të fortë dhe i llojit Zink-Alumin në raportin Zn 95% dhe Al 5%. Sasitë minimale të zinkut kenafin dispozitat e BS 443/82 dhe kalojnë ato të ASTM A641-71A, DIN 1548, QQ-Ē-461 H.

Montimi dhe vendosja në veper e gabionave. Hapen elementet, ngrihen këndet dhe diafragmat dhe lidhen në panelet anësore. Teli lidhës është vendosur së bashku me gabionat. Për një lidhje të sakte, teli duhet të kalojë nepermjet çdo hojjeje, duke bërë një rrugë të dyfishtë të lidhjes (e alternuar një po një jo, Fig.33).

Në vend të telit lidhës mund të përdoren lidhje metalike të mekanizuara në çelik (Fig.35) me karakteristikat e mëposhtme:

Rezistenca në tërheqje 170kg/mm²

Mbrojtje me Zink-Alumin

Diametri: 3.00mm

Gabionat e parashikuar në projekt me permasa (1x1x1)m, (1x1x1.5)m dhe (1x1x2)m do të mbushen me gurë të sistemuar, si mure guri të rregullt në të thatë, ku guret të jenë të lidhura në mënyrë të rregullt dhe do të kenë permasa 12-40cm. Në qoshtet e gabionave të vendosen gurë me dimension të madh, kurse guret me dimensione më të vogla të përdoren për të bërë lidhjen dhe mbushjen e boshllëqeve.

Kubiket e gabioneve të vendosen në mënyrë të alternuar në drejtimin tërthor të prites, gabariti gjatësor i tyre të jetë paralel sipas aksit tërthor të pritave.

Guret duhet të kenë karakteristika të fortësisë jo të shkrifet.

Lidhen kapaket me të njëjtin proces lidhjeje. Masa vëllimore e gabionave duhet të jetë minimumi 1.73 ton/m³. Kjo provë duhet të kryhet për çdo 500m³ vendosje gabionash.

Tab.2 Kombinim standartesh, Hoje – Tel

Tipi	D(mm)	Toleranca	Φ telit (mm)
8x10	80	+16% -4%	3

Tab.3 karakteristikat gjeometrike te gabionave

Gjatesi (m)	Gjeresi (m)	Lartesi (m)	Toleranca
1.5	1	1	Gjatesi ± 5% Gjeresi ± 5% Lartesi ± 5%
2	1	0.5 - 1	
3	1	0.5 - 1	
4	1	0.5 - 1	

Tab.4 Karakteristikat e telit te gabionave

Pershkrimi	Φ telit (mm)	Toleranca e Φ (mm)	Sasia e Zn
Teli i hojeve	3	0.06	265
Teli rrethues	3.9	0.07	280
Teli lidhes me dore	2.4	0.06	255
Teli lidhes ne menyre mekanike	3	0.06	265

Shenim: Te gjithë gabionat duhet te jene lidhur me njeri tjetrin pergjate aneve me te njejten forme lidhjeje.

LIDHJA E RRJETAVE ME TEL XINGATO




Fig.35 Lidhja e rrjetave me tel xingato

PAMJE E RULONIT TE RRJETES SE GABIONIT





Fig.36 Pamje e rrolonit te rrjetes se gabionit



2. STUDIMET NDIHMESE PER HARTIMIN E PROJEKT- ZBATIMIT TE STRUKTURAVE PER SISTEMIMIN E LUMIT TE GOMSIQES

2.1 STUDIMI HIDROLOGJIK

Termat e References kerkojne nje studim te detajuar hidrologjik per pellgun e lumit te Gomsiqes duke u perqendruar ne prurjet maksimale me siguri te ndryshme.

Shpërndarja e çrregullt e reshjeve përgjatë vitit dhe shkëmbinjtë e përmendur në pikën 2.2 janë arsyeja e regjimit të çrregullt të rrjedhave të ujit në disa degë në rajon. Gjatë sezonit të thatë (gjatë verës) disa përrenj në zonë thahen, ndërsa të tjerë kanë një rrjedhë të kufizuar. Më i bollshmi me ujë është Fani i Madh dhe Lumi i Gomsiqes, të cilat janë përherë me ujë të rrjedhshëm.

Pellgu ujembledhes i lumit te Gomsiqes ndodhet ne shpatin e majte te lumit Drin. Ne vendmatjen hidrometrike Gomsiqja Kuota +100.00, ai ka nje siperfaqe te pellgut ujembledhes 144 km² dhe mbledh ujerat e rreshjeve, te cilat marrin vlera nga 2000 mm deri 2300 mm.

Pellgu ujembledhes i lumit te Gomsiqes ka nje shtrirje nga perendimi ne lindje dhe perbehet nga shume degezime perrenjesh te tjere te cilet kane prurje te konsiderueshme. Siaps ndarjes administrative Pellgu ujembledhes eshte pjese e bashkise se Pukes, ku qyteti i Pukes eshte ne lindje te pellgut ujembledhes (shih hartin topografike te zones). Ne veri pellgu ujembledhes

kufizohet nga vazhdimi i Lumit Drin, ne jug vija ujendarese e pellgut ujembledhes ndahet nga mali i Mrozit ▼+606.00m, duke vazhduar me malin e Gjtitit ▼+891.3m, e duke vazhduar me kurrizin e Hardopit ▼+809.00 m. Ne perendim eshte grykederdhja e perroit te Gomsiqes ne liqenin e Vaut te Dejes, rreth kuotes ▼+70.00 m.

Nga pikepamja hidrometeorologjike lumi i Gomsiqes dallohet per nje ujeshmeri te larte. Moduli mesatar vjetor kalon vleren prej 50 l/s.km", Njekohehishte ai karakterizohet prej nje regjimi tipik mesdhetar, me plota te larta ne periudhen e laget dhe prurje relativisht te vogla gjate periudhes se thate te vitit. Raporti i prurjes mesatare mujore te muajit dhjetor me prurjen ne muajin korrik eshte me i madh se 10, gje qe deshmon per nje ndryshueshmeri te larte brendavjetore te rrjedhjes.

Ne kete studim, i cili kryhet ne kuadrin e projektimit te "**Hartim projekti mbrojtje dhe sistemim me prita malore i perroit te Gomsiqes**" ne kete lume, trajtohen keta elemente hidrologjike:

- Kushtet klimatike te pellgut te perroit te Gomsiqes
- Reshjet mujore dhe vjetore te zones se projektit
- Reshjet ne forme bore ne zonen e projektit
- Karakteristikat hidrologjike te pellgut te Gomsiqes
- Llogaritjet e prurjeve maksimale me siguri te ndryshme
- Rrjedhja e ngurte e pellgut te gomsiqes

Studimi mbeshtetet mbi te dhenat hidrologjike te Institutit Hidrometeorologjik te matura ne stacionin hidrometrik te lumit te Gomsiqes ne Uren e Hoxhes gjate periudhes 1961-1990 si dhe te dhenave te matura te prr i Gomsiqes ne Kuoten + 100.00 gjate periudhes 1961-2000 (matje keto te realizuara per nje periudhe 40 vjecare).

Pozicioni i pellgut ujembledhes te Gomsiqes ne hartin e Shqiperise jepet ne figuren 2.



Fig. 38. Pozicioni i pellgut ujembledhës të Gomsiqes

▪ **Kushtet klimatike te pellgut te perroit te Gomsiqes**

Zona ku shtrihet pellgu i Gomsiqes bazuar ne ndarjen klimaterike te vendit tone (figura nr.2) i perket zones klimatike mesdhetare veriore. Temperatura mesatare vjetore lekundet nga rreth 10.1 °C ne Puke. Ndersa temperatura minimale ne Puke arrijne deri ne rreth -25°C. Periudha me temperatura negative ne zone zgjat deri 73 dite ne vit ndersa me temperatura me te vogla se -5° C zgjat deri ne 14 dite ne vit.

Ne pjesen perendimore te nenzones, ku ndodhet edhe shuma vjetore e rreshjeve arrin ne 2000-2300 mm. Numri i diteve me rreshje me te medha se 1 mm eshte mbi 100 dite. Trashesia maksimale e bores arrin deri 1.5m. Numri i diteve me bore eshte 35-40 dite.

Temperaturat maksimale te regjistruara ne Puke arrijne deri ne 39.0°C. Nga pikpamja e sasise se rreshjeve qe bien ne zone futet ne zonat me me shume rreshje ne Shqiperi. Sasia mesatare e rreshjeve qe bien ne zone lekunden ne rreth 2000-2300 mm ne Puke.

Per natyren e projektit ne shqyrtim rendesi kane rreshjet maksimale per zgjatje te ndryshme dhe intensiteti i tyre. Rreshjet maksimale 24 oreshe ne Puke jane 200-250 mm.


Për stacionin e Pukes parametrat klimaterike janë përmbledhur në tabelën Nr.5

EMËRTIMI	VL. E PARAMETRAVE NE ST. FIERZES
TEMPERATURA MESATARE VJETORE	10.1
TEMPERATURA MESATARE ME E LARTE NE VERE	25
TEMPERATURA ME E LARTE ABSOLUTE	39.0
TEMPERATURA MESATARE ME E ULET NE DIMER	0
TEMPERATURA ME E ULET ABSOLUTE	-25
RESHJET MESATARE VJETORE	2150
RESHJET ME TE MEDHA VJETORE	3450
RESHJET ME TE VOGLA VJETORE	1200
RESHJET ME TE MEDHAJA 24 ORESHE	250
TRASHESIA MAKSIMALE E BORES	150 cm
INTENSJTETI I LEKUNDJEVE SIZMIKE	7 balle

Tab.5 Parametrat klimaterike per stacionin e Pukes (burimi: Raporti hidrologjik i projektit te meparshem)

Rajonizimi klimatik. Ndarja e territorit të një vendi në zona e nënzona e në njësi të tjera më të vogla me kushte klimatike pak a shumë të njëjta, duke u mbështetur në regjimin shumëvjeçar të elementeve meteorologjike që rrjedhitt nga një radhë faktorësh (pozita gjeografike, lartësia absolute, largësia nga deti etj.).

Megjithëse përpjekje për R.K. të Shqipërisë janë bërë edhe para Çlirimit, si rajonizim i parë mund të merret ai i Drejtorisë së Shërbimit Hidrometeorologjik të Institutit të Shkencave (1355). Në këtë R. K. të Shqipërisë territori ndahet në 3 zona me nga 3 nënzona: I. Mesdhetare atlantike (V, qendrore e J); II. Kalimtare (V, qendrore e J,); III. Mesdhetare kontinentale (V, qendrore e J). Bazohet në dukjen e masave ajrore detare ose kontinentale të ftohta a të ngrohta, që mbizotërojnë në periudha të ndryshme të vitit. Grumbullimi i të dhënave të shumta meteorologjike bëri të mundur një R. K të ri të vendit të bazuar në kritere më shkencore që u paraqit më 1972 në studimin «Klima e Shqipërisë» (shih).



Sipas këtij R. K. territori i Shqipërisë ndahet në 4 zona klimatike me 13 nënzona: I. Zona mesdhetare fushore (shih) me nënzonat V, qendrore e J; II Zona mesdhetare kodrinore (shih) me nënzonat V, qendrore, JL e JP; III. Zona mesdhetare paramalore (shih) me nënzonat V e J; IV. Zona mesdhetare malore (shih) me nënzonat V, L, JL e J.

Fig.39 Zonat dhe nen-zonat e klimes se Shqiperi.

▪ **Reshjet mujore dhe vjetore te zones se perroit**




Fig.40 Lartësitë mesatare të reshjeve dhe histogramat e tyre mbi hartën e zonës së projektit







Fig.41 Lartësitë mesatare të reshjeve dhe histogramat e tyre mbi hartën e Shqipërisë

Reshjet mesatare mujore per stacionin e marre ne konsiderate jepen ne tabelen Nr.5

Muajt	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
Rreshjet	240	201	178	176	132	89	60	91	150	212	288	286

Tab.6 Prurjet maksimale 24 oreshe ne kete zone ato jane mjaft te larta dhe arrijne vlerat 200 deri 250 mm.

Ne forme grafike reshjet mesatare jepen ne grafikun Nr.1



Grafiku Nr.1 Reshjet mesatare dhe vjetore ne stacionin e Pukes

▪ Karakteristikat hidrologjike te pellgut te Gomsiqes

Faktoret baze qe percaktojne karakteristikat hidrologjike te zones se projektit jane klima, topografia dhe gjeomorfologjia e saj.

Pellgu ujembledhes i Gomsiqes shtrihet ne pjesen lindore te Alpeve te Shqiperise dhe pozicionohet ndermjet pellgjeve ujembledhes te lumit Curraj ne veri dhe veri-lindje dhe Shales ne veri-perendim dhe perendim.

Siperfaqja e pellgut ujembledhes deri ne dedhje eshte rreth 144 km². Gjatesia ujerrjedhese e pellgut eshte rreth 23.5 km dhe pjerresia mesatare e shtratit te deges kryesore eshte rreth 21 % e cila eshte me e theksuar ne pjeset e larta te pellgut dhe me e bute ne rrjedhjen e poshtme te pellgut. Pellgu ujembledhes jepet ne figuren Nr.6.




Fig. 42 Rrjeti hidrologjik, pellgu ujembledhes i perroit te Gomsiqes.

Perroi i Gomsiqes e ka zanafillen e tij nga shpati lindor (m.Saka e prenkalit $\nabla + 1298\text{m}$). dhe verior nga m.pjarit $\nabla + 942\text{m}$ dhe m. Rases se Qerretit $\nabla + 982.10\text{m}$. Nga ana lindore ai emertohet prr i Gomsiqes deri ne kuoten 307 m ku bashkohet me nje nga deget me te rendesishme e e cila vjen nga ana e djathte e rrjedhes e emertuar prr. Gomsiqe e vogel. Por para se te bashkohet me kete dege ajo ka marre me vete dhe Degen e emertuar prr. Gomsiqes se bjeshkes e cila bashkohet rreth kuotes $\nabla + 412\text{ m}$.

Lumi i Gomsiqes bashke me deget e siperpermendura tani ka formuar shtratin e gjere te tij sepse prurja pas bashkimit te ketyre degeve eshte e konsiderueshme dhe duke vijuar ne drejtim te lindjes ai mbledh akoma prroska te tjera me prurje me te vogla qe ruan njetrajtshmerine e tij deri ku bashkohet me degen tjeter te rendesishme te pellgut prr. e Dushit, e cila buron nga ana veriore dhe bashkohet me prr. e Gomsiqes rreth kuotes $\nabla + 300\text{ m}$. Nga bashkim i tyre jane dhe rreth 5 km gjatesi deri ne derdhje te prr. te Gomsiqes e liqenin e Vaut te Dejes. Gjate ketij segmenti ne perrua derdhen edhe disa prroska te tjera, me prurje te konsiderueshme te cilat burojne nga ana e djathte e rrjedhes. Ne kete segment shtrihet dhe zona ne studim per mbrojtjen me prita malore.

Rrjeti hidrografik i pellgut te Gomsiqes karakterizohet nga dege me pjerresi te medha kryesisht ne pjesen e siperme te tij por edhe ne anen e poshtme te pellgut. Megjithate duhet theksuar se ne rrjedhen e poshtme ne derdhje ne liqenin e Vaut te Dejes pjerresia e shtratit ka ndryshuar ne menyre te konsiderueshme si rezultat i grumbillimit te prurjeve te ngurta ne delten e shkarkimit ne kete liqen. Kuota e shkarkimit ne liqenin e Vaut te dejes eshte ngritur ndjeshem duke ndikuar edhe ne zvogelimin e pjerresise natyrale te shtratit te perroit.

Pellgu perbehet nga siperfaqe te thepisura me lugina te thella dhe te ngushta me nje hidrografi te karakterizuar nga rrjedha te vrullshme dhe te shkurtra dhe si rezultat te shoqeruara me gerryerje te konsiderueshme per shkak te shpejtesive te medha te gjeneruara.

Zona në studim që konsiston nga pike-bashkimi rreth kuotes $\nabla + 133.2$ m deri në derdhje në liqenin e Komanit karakterizohet nga një gryke në formë kanioni që ngushohet dhe zgjerohet në mënyrë alternative por që nuk kontribuon shumë në prurje dhe material të ngurte.

Plotat maksimale në pellgun e Gomsiqes formohen si rezultat i shirave të dendur me intensitet të lartë dhe të vazhdueshëm. Në pjesën dermuese ato krijohen në periudhën e vonë të vjeshtës dhe gjatë dimrit.

Për qëllimin e projektit të llogaritjet hidrologjike janë bërë vetëm për prurjet maksimale duke llogaritur plotat për zgjatje të ndryshme të shirave si dhe periudhë perseritje të ndryshme. Për llogaritjet hidrologjike janë shfrytëzuar të dhënat e stacionit të Pukes.

Perroi i Gomsiqes ndodhet në bregun e majtë të liqenit të Vau Dejes dhe zbrit nga lartësia e fshatit me të njëjtin emër. Në drejtim të tipareve gjeomorfologjike, lugina ku rrjedh perroi i Gomsiqes, karakterizohet nga tipare të ashpra morfologjike ku shpatet ngrihen dhe zbresin rreptshëm në lugine deri në derdhejen e perroit në liqenin e Vau Dejes.

Lugina e Perroit të Gomsiqes karakterizohet nga një morfologji pothuajse uniforme pasi ndertimi gjeologjik i shpatëve në këto dy rrjedha është i njëjtit. Megjithatë fenomeni i erozionit është më i theksuar në të dy faqet e lugines dhe degeve të perrenjeve të tjera që derdhen në këto perrua.

